



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 486/1 Prot.

Tiranë, më 27 / 03 / 2019

**V E N D I M**

**Nr. 44 , Datë 27 / 03 / 2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.152 Regj., datë 20.09.2018, të I. S, kundër Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), me pretendimin për diskriminim për shkak të “*shtatzanisë*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Subjekti ankues, I. S, me datë 05.02.2018 është emëruar “Specialiste” në Sektorin e Dixhitalizimit të Kartelave pranë ZQRPP-së dhe ka nënshkruar një kontratë me afat gjashtë mujor. Në momentin e nënshkrimit të kontratës, ankuesja ka qenë në muajin e gjashtë të shtatzanisë. Me datë 01.06.2018 ka marrë lejen e barrë lindjes. Me datë 01.08.2018 I. S shprehet se është njoftuar verbalisht përmes kolegëve të punës se i ishte komunikuar njoftimi për përfundimin e marrëdhënieve të punës, për shkak të përfundimit të afatit 6-mujor të kontratës së punës, komunikim i cili nuk i është bërë zyrtarisht.

Ankuesja shprehet se largimi nga puna ka qenë selektiv për shkak se të gjithë të punësuarve të tjerë me kontrata 6-mujore, në përfundim të këtij afati iu janë rinovuar kontratat e punës dhe ata

---

<sup>1</sup>Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

vijojnë punën normalisht, ndërsa asaj i është dërguar njoftimi për largim nga puna pikërisht në momentin që ajo kishte nisur lejen e lindjes. Ankuesja pretendon se, duke qenë se ishte në periudhën e mbrojtjes së veçantë, bazuar në Kodin e Punës, afati i njoftimit duhet të bëhej pas përfundimit të periudhës së mbrojtjes dhe për këtë arsye, ankuesja shpreh bindjen se përfundimi i marrëdhënies së punës ka ardhur si rrjedhojë e faktit se ajo ishte me leje lindje.

Në përfundim të ankesës së saj, I. S. kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të saj nga ana e punëdhënësit, për shkak të shtatzanisë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1308/1 prot., datë 26.09.2018 i është kërkuar informacion ZQRPP Tiranë, lidhur me pretendimin e I. S.

---

<sup>2</sup>Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Me shkresën me nr.7753/1 prot., datë 12.10.2018<sup>3</sup> ZQRPP Tiranë, ka dërguar një pjesë të dokumentacionit të dosjes personale të I. S dhe ka informuar Komisionerin se: *“Me anë të Urdhërit nr.1463 prot., datë 05.02.2018 I. S është emëruar në pozicionin e specialistes, me kontratë të përkohshme pranë ZQRPP, në mbështetje të Vendimit nr.3, datë 22.12.2017 të Bordit Drejtues të ZQRPP-së “Për vijimsinë e Projektit të Përmirësim/Përditësimit dhe Regjistrimit Fillestar”. Bazuar në këtë urdhër mes ZQRPP-së dhe I. S është nënshkruar kontrata individuale e punës me afat të caktuar për periudhën 05.02.2018-05.08.2018, sipas parashikimeve të nenit 149, të Kodit të Punës.*

*Në përfundim të këtij afati, I. S është njoftuar me anë të shkresës me nr.6485 prot., datë 31.07.2018 se me datë 05.08.2018, sipas afatit të përcaktuar në kontratën individuale të punës, marrëdhënia e punës dhe ajo financiare me ZQRPP përfundon”.*

Lidhur me pretendimin e ankueses se përfundimi i marrëdhënieve të punës ka ardhur si rrjedhojë e faktit se ajo ishte me leje lindjeje, ZQRPP sqaron se, marrëdhënia juridike e punës mes ZQRPP-së dhe I. S ka përfunduar në fund të kohës së parashikuar në kontratë (05.08.2018) dhe jo në kohën kur është mësuar për shtatzaninë e punëmarrësit (01.06.2018), vërtetuar me Raportin e barrë lindjes. Në këto kushte, ZQRPP kundërshton faktin se largimi i saj nga puna ka ardhur për shkak të diskriminimit të pretenduar nga subjekti ankues.

Po ashtu, ZQRPP ka sjellë në vëmendje të Komisionerit se, Projekti i Përmirësim/Përditësimit dhe Regjistrimit Fillestar, është një projekt i cili miratohet për periudha dhe objektiva të caktuara nga Bordi Drejtues i ZQRPP-së dhe si i tillë, lidhur me natyrën e përkohshme të punës dhe kontratat e punonjësve që rekrutohen për këtë qëllim, pranë këtij projekti, lidhen me një afat të caktuar, bazuar në nenin 149, të Kodit të Punës.

Në vijim të parashtrimeve të veta, ZQRPP thekson faktin se, duke qenë se aktualisht, I. S është duke përfituar nga Leja e lindjes dhe paguhet në përputhje me ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në përfundim të kësaj kohe, me kërkesën dhe vullnetin e saj mund të kërkojë të punësohet pranë Projektit të Përmirësim/Përditësimit dhe Regjistrimit Fillestar, nëse vazhdon vijimsia e tij si projekt pranë ZQRPP-së.

2. Me shkresën me nr.1308/3 prot., datë 05.11.2018 Komisioneri ka kërkuar informacion dhe dokumentacion shtesë<sup>4</sup> nga ZQRPP-ja lidhur me shqyrtimin e çështjes së I. S.

---

<sup>3</sup> Protokolluar me Tonën me nr.1308/2 prot., datë 16.10.2018.

<sup>4</sup> Eshtë kërkuar specifikisht:

- Për periudhën 1 Qershor 2018 e në vijim a janë marrë punonjës të tjerë me kontratë të përkohshme, nga ZQRPP-ja, në zbatim të Vendimit nr.3, datë 22.12.2017 të Bordit Drejtues të ZRPP-së “Për vijimsinë e Projektit/Përditësimit dhe Regjistrimit Fillestar”?
- Nëse po, sa është numri i këtyre punonjësve dhe një kopje e procedurës së emërimit dhe kontratave të punës për secilin rast.
- Kopje të kontratës së punës të ankueses.
- Informacion mbi numrin e punonjësve të punësuar në të njëjtën periudhë kohore me ankuesen , me kontrata gjashtë mujore. (Një kopje e emërimeve për secilin rast)

Me shkresën me nr.7753/3 prot., datë 21.11.2018 ZQRPP ka informuar Komisionerin se: “Për periudhën I Qershor 2018 e në vijim në bazë të Vendimit nr.3, datë 22.12.2017 të Bordit Drejtues të ZQRPP-së janë punësuar 43 punonjës me kontratë me afat të caktuar. Numri i punonjësve me kontratë me afat të caktuar, (6 mujor) të emëruar në të njëjtën kohë me ankuesen (05.02.2018) është 33 punonjës.

Numri i punonjësve të larguar pas përfundimit të afatit të kontratës është 23 dhe numri i punonjësve që pas përfundimit të afatit të kontratës iu dha mundësia për të rinovuar kontratën e punës po me afat të caktuar, është 10. (Kopje të këtyre kontratave nuk mund t’jua vëmë në dispozicion pasi përmbajnë të dhëna personale”.

ZQRPP në vijim të përgjigjes ka theksuar se, I. S nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për t’u ripunësuar pranë Projektit të Përmirësim/Përditësimit dhe Regjistrimit Fillestar, pasi duke qenë se projekti është në vazhdimësi të punës së tij, ngelet e hapur mundësia që ajo të punësohet, me kërkesën e saj në rast se do të ekzistojë dhe vullneti i saj.

3. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr.10 221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së I. S, Komisioneri me datë 17.01.2019<sup>5</sup> realizoi një seancë dëgjimore me palët në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e të dy palëve në proces: subjektit ankues, personalisht, dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, G. M, përfaqësuese me autorizim<sup>6</sup> e ZQRPP Tiranë.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në. Nga ana e përfaqësuese së ZQRPP-së u shpreh se nga ana e institucionit do të shihet mundësia për lidhjen e një kontrate të re me ankuesen, nëse ajo shpreh vullnetin për një gjë të tillë, por përgjigje shkresore zyrtare, do të dërgohej në vijim.

Me anë të shkresës me nr. 123/1 prot., datë 06.03.2019, ZQRPP informon Komisionerin, në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore se, mundësia që I. S të punësohet pranë Projektit të Përmirësim/Përditësimit dhe Regjistrimit Fillestar është e hapur dhe se, nëse ajo dëshiron të punësohet si specialiste në këtë projekt, duhet të dorëzojë një kërkesë me shkrim pranë protokollit të ZQRPP-së ku të shprehë vullnetin e saj në lidhje me rikthimin në vendin e punës.

Nëpërmjet shkresës me nr.411 prot., datë 18.03.2019 subjekti ankues ka dërguar për dijeni pranë KMD-së kërkesën e saj drejtuar ZQRPP Tiranë, për rifillimin e marrëdhënieve të punës, në të cilën citohet: “Duke qenë se në shkresën tuaj drejtuar Komisionerit jeni shprehur se mundësia për

- 
- Informacion mbi numrin e punonjësve të larguar pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën gjashtë mujore. (Një kopje të procedurës për secilin rast)
  - Informacion mbi numrin e punonjësve të cilëve iu është rinovuar kontrata pas përfundimit të afatit gjashtë mujor, si dhe parashtrime mbi arsyet e rinovimit, nëse ka. (Kopje e procedurës për secilin rast).

<sup>5</sup> Referuar “Njoftimit për shtyrje të seancës dëgjimore” me nr.29 prot., datë 07.01.2019. Dokumentacioni përkatës ndodhet i depozituar në Dosjen personale të subjektit ankues, pranë KMD-së.

<sup>6</sup> Me shkresën me nr. extra prot., datë 17/01/2019 të ZQRPP Tiranë.

*mua për t'u ripunësuar mbetet e hapur, në kuadër të vazhdimësisë së Projektit<sup>7</sup>, kërkoj që pas përfundimit të raportit mjekësor/ leje lindjeje, përkatësisht në datën 12.04.2019 të rifilloj marrëdhënien e punës, duke u punësuar pranë Projektit të Përmirësim/Përditësimit dhe Regjistrimit Fillestar”.*

Nga ana tjetër, nëpërmjet e-mailit të saj dërguar KMD-së<sup>8</sup>, subjekti ankues, ka kërkuar ndërprerjen e procedurës hetimore nga ana e Komisionerit, për shkak se konsideron të përmbushur në thelb qëllimin për të cilin kishte iniciuar ankesën. Por njëherësh, duke qenë se kërkesa e saj prezumohet të përmbushet pas datës 12.04.2019, ajo thekson se në rast të kundërt, do të paraqesë rishtaz ankesë të re tek KMD.

Neni 33, pika 9 e LMD ka parashikuar se: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”.*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin dhe kishte iniciuar ankesa.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), c), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nenin 94, pika 1 e Kodit të Procedurës Administrative,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës së I. S kundër kundër Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP), pasi u arrit efektiviteti dhe qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. ZQRPP, në momentin e lidhjes së kontratës së punës me subjektin ankues, të dërgojë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi një kopje të Urdhërit të emërimit të saj.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

<sup>7</sup> Projektit të Përmirësim/Përditësimit dhe Regjistrimit Fillestar.

<sup>8</sup> Adresa e e-mailit të ankuesit: \_\_\_\_\_@gmail.com

Adresa: Rruga e Durrësit, Kodi postar 1001, (Ish-Ministria e Mjedisit), Tiranë, Tel: +355 4 2431078, e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

## **KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha: Punësim  
Shkaku: Shtatzania